



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/13

Datë: 13.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të nenit 41, neni 50 të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Nga data 13 korrik 2020, duke filluar nga ora 21:00 deri në orën 05:00, ndalohej çfarëdo qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunitet: Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë Kosovë dhe Shtërpçë, përveç:
 - 1.1. Në raste urgjente shëndetësore;
 - 1.2. Në rast të nevojës për t'u kujdesur për të sëmurë, për persona me nevojë të veçantë, vetëm nëse të sëmurët apo personat me nevojë të veçantë nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten;
 - 1.3. Në rast të kërimit të ndihmës nga institucione përkatëse, siç është rasti me viktimat e dhunës familjare;
 - 1.4. Në rast të vdekjes së anëtarit të familjes;
 - 1.5. Në rast të paraqitjes së nevojave për dalje jashtë shtëpisë/banesës për nevojat fiziologjike të kafshëve, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia (por, nuk lejohet shfrytëzimi i këtyre rasteve për të kryer ndonjë punë tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar).
2. Obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër.

A r s y e t i m

Meqenëse në ditët e fundit ka rritje të rasteve të prekura me COVID-19, në komunitet përkatëse, kjo mund të shpie në përhapje masive të virusit, që do të rrezikon seriozisht shëndetin publik me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë